



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 14/15/2023  
Data: 20.02.2023

### PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e -I- parë për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.01.2023 me fillim pune në ora 10:30 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete. Prezent ishin : Kimete Kuka- Hasallari , Amir Bushi , Hisni Luri, Naxhmedin Daci , Abdurrahman Bushi

### RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Njohuri me kompencat e Komitetit për Komunitete
- 3.Takim me Drejtoren e Shëndetësisë.
- 4.Rastet Sociale në Komunën e Hanit Elezit
- 5.Takim me drejtoren e Mirëqenies Sociale
- 6.Eventuale

**Kryesuesi** thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA RENDI I PUNËS

#### 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2.Njohuri me kompencat e Komitetit për Komunitete**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë e kam një doracak të vitit 2010 për kompetencat kompetencat e Komitetit për Komunitete janë në pajtim LVL (Ligji Vetëqeverisjes Lokale ) dhe me statutin e komunës ,komiteti për Komunitete përpinqet që brenda territorit të komunës të siguroj se komiteti për komunitetit është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë autoriteteve komunale me ligjin në zbatim për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale praktikave dhe aktiviteteve për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, komiteti gjithashtu rekomandon Kuvendin e Komunës masat që duhet të ndërmerrin për të siguruar jetësimin e depozitave që kanë të bëjë me nevojën e komitetit për të avancuar shprehur mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik kulturor fetar dhe gjuhësor si dhe për të siguruar mbrojtjen adekuate e të drejtave e komuniteteve brenda komunës që ushtron edhe përgjegjësi tjera .

## **3.Takim me Drejtorinë e Shëndëtsisë**

**Kryesuesi** thekson: Kohëve të fundit ka pas vërvshime nga shiu dhe uji është turbullu çfar keni ndërmarr për ti njoftuar qytetarët?

**Kimete Kuka Hasallari** :- problemi me i madh tek ne është uji sidomos kur ka reshje pasi që është i pa pijshëm , unë kam bërë kontratë me institutin e shëndetësisë së paku në 3 muaj të bëjnë analiza e të gjitha burimeve të ujit . Në dhjetor kam bërë 17 analiza në burime , vetëm në 3 burime kanë dal që janë të pa pijshme ata kanë rekomanduar që të bëhet edhe dezinfektimi i burimeve të ujit por me qënse janë burime private duhet marrur masat vet .

**Hanumshahe Dirbani** :- Uji i Glloboqices a është i pijshëm , dhe tek ato 3 burime që janë të papijshme a i keni njoftuar qytetarët që furnizohen me ujë nga ata burime.

**Kimete Kuka Hasallari**:- Po është i pijshëm, po janë të njoftuar me analizat e ujit .

**Zaim Bela** thekson:- Duhet të njoftuar edhe qytetareve tjerë për burimet që janë të pa përdorshme

**Kimete Kuka Hasallari** thekson:- Kam për ta përcjell në faqe zyrtare dhe kam për të përcjell edhe juve

**Kryesuesi** thekson:- Si vepron kujdestaria në QKMF sa staf ka në kujdestari ?

**Kimete Kuka Hasallari** :- një mjek dhe dy infermier ,por mjeku është edhe vozitës pasi që kemi mungesë të vozitësit në raste emergjente , Orari i mjekësisë familjare është nga 07:00-15:00 që është ma gjithë përfshirëse sepse ka sektorin e diagnoztikës , vaksinimit , stomatologjisë , ndërsa kujdestaria ka 15:00- deri në mëngjes 07:00.

**Kryesuesi** thekson:- Kam dëgjuar që stafi i kujdestarisë gjatë orarit bëjnë gjumë kanë leje të bëjnë gjumë.

**Kimete Kuka Hasallari**: Me leje nuk është e lejuar por duke u nisur si qenie njerëzore kuptohemi së 16 orë punë është e lodhshme .

**Zaim Bela** thekson:- A je kompletuar me staf në QKMF dhe a ka mungesë të stafit?

**Kimete Kuka Hasallari** thekson:- momentalisht stafi është në mungesë nga viti 2009 prej që ka filluar stafi emergjent ,kërkeshat janë të një pas njëshme në bazë të udhëzimit administrativ parashihet që për mjekësi familjare të jetë një mjek dhe dy infermier për 2000 banor realisht na nuk e plotësojmë as 50% nuk e mbulojmë me këtë staf , kam has edhe kërkesa që janë më herët por përsëri nuk kemi diçka .

**Resul Suma** thekson:- A keni biseduar me organizatën islamik Relief

**Kimete Kuka Hasallari** thekson : edhe aty kemi pas takime bashkëbisedime por duhet të bëjë kërkësë për shtim të stafit ,kam për të lenë një takim pasi që kemi një nevojë emergjente për staf.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- 3 infermieret që janë pranuar me kontratë a do të i'u vazhdohet kontrata pasi që janë bërë 3 muaj, dhe a keni biseduar me kompaninë Sharrcem ?

**Kimete Kuka Hasallari** thekson:- Nuk mundemi me e vazhdu , duhet të shpallim konkurs për pranim. Kompania Sharrcem na ka mundësuar një stomatolog dhe një infermier.

**Kryesuesi** thekson:- cilat sëmundje janë më të përhapura në Komunën tonë ?

**Kimete Kuka Hasallari** thekson:- Numër të saktë nuk mundem të ju garantoj pasi që ka sëmundje të ndryshme në sezonë gripe po edhe diabeti është një sëmundje që ka numër të madh të pacientëve .

#### 4.Rastet Sociale në Komunën e Hanit Elezit

**Amir Bushi** thekson:- qendra sociale është një institucion që vepron në kuadër të drejtorisë shëndetësise dhe mirëqenies sociale ku i ka kompetencat e ndara , ku pagesat bëhen nga ministria ndërsa menaxhimi bëhet nga Komuna , Qendra sociale ka dy sektor ndihma sociale dhe shërbimet sociale , raste sociale i kemi 121 familje.

**Kryesuesi** thekson:- a ka familje pa strehë.

**Amir Bushi** thekson:- Pa strehë nuk ka ,por që jetojnë në bashkësi me shumë anëtarë në kushte të vështira ndërsa pa strehë nuk ka .

**Kryesuesi** thekson:- Kryerja e shërbimeve sociale dhe familjare për punë sociale ose duke siguruar financim nga organizatat jo qeveritare , çfarë lidhje ka OJQ me qendrën sociale .

**Amir Bushi** thekson :- parandalimi i dukurive negative bëhet edhe prej organizatave jo qeveritare , po ashtu edhe strehimorja që është në Ferizaj nëse nuk kemi bashkëpunim në nuk mundemi të rehabilitojmë ndonjë familje .

**Kryesuesi** thekson:- A ka raste dhunë në familje ?

**Amir Bushi** thekson:- Për fat të mirë dhunë nuk ka shume të referuara.

#### 5.Takim me drejtorinë e Mirëqenies Sociale.

U diskutua ne pikën Rastet Sociale në Komunën e Hanit Elezit


## **6.Eventuale**

Nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoj në 11:50

**Procesmbajtësja**

**Sara Berisha**



**Kryesuesi i Komitetit**

**Mefail Suma**

